

REPUBLICA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

Nr. 1892 Rregj.Themeltar

VENDIM

“Për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE - ELONA MIHALI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Rezarta Lazaj, sot më 04.06.2015 në seancë pregatitore, mori në shqyrtim kërkesën e palës paditëse për sigurimin e padisë që i përket çështjes civile me Nr. 1892 Rregj.Themeltar me palë ndërgjyqëse:

Paditës:

Mantho Bua, i biri i Spiro dhe Athina, datëlindje 1945, lindur dhe banues në Dhërmi, Himarë, Vlorë.

I paditur:

Stefo Bua, i biri i Spiro dhe Athina, datëlindje 1953, lindur dhe banues në Dhërmi, Himarë, Vlorë.

Objekti:

1. Konstatimi dhe deklarimi i pavlefshmërisë absolute (teresisht i pavlefshëm) të veprimit juridik testamentit nr.2 dt. 15.01.1986 dhe nr.12 repertori lëshuar nga Athina Buat trashëgimtarit Stefo Bua dhe thirrja në trashëgim e trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerës Athina Bua për pasurinë e lënë nga ajo në këtë testament.
2. Pezullimi i çdo lloj transkaioni (shitje-blerje) të tokës së rregjistruar në emër të Stefo Bua, i cili rrjedh nga ky testament deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

Bazë ligjore:

Nenet 31, 32 e 202 vijues të K.P.Civile aktual neni 92 i K.Civil aktual, neneve 17 e 118 të Kodit Civil të vitit 1981, ligji mbi “Zyrat juridike pranë Gjykatave”, Ligji “Për Noterine” (Aktual i ndryshuar), nenet 46, 49.

Si konkluzion, rezulton se:

- Plotësohen në mënyrë kumulative elementët e mësipërm, kritere ligjore të domosdoshme për lejimin e sigurimit të padisë, konkretisht ekzistenca e një drejte subjektive, ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova mbi pamundësinë ose vështirësinë e vënies në jetë të së drejtës subjektive si dhe mbështetja e kërkesës në prova shkresore, duke përjashtuar prova të llojeve të tjera nga ato që parashikon K.P.Civile.
- Lloji i masës së sigurimit është proporcional dhe ruan balancën e interesave mes palëve ndërgjyqëse.

Në analizë të të gjithë elementëve ligjore të mësipërm si dhe bazuar në provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, gjykata vlerëson se kërkesa për sigurimin e padisë duhet të pranohet:

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenin 125, 158/a, 202-212 të Kodit të Procedurës Civile, Vendimin Unifikues nr. 10, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 227, datë 08.05.2012, Vendimit nr.479, datë 27.10.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Vendim nr. 22, datë 19.01.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Sigurimin e padisë duke urdhëruar pezullimin e çdo lloj veprimi mbi pasurinë trashëgimore të paluajtshme të llojit "Tokë" të rregjistruar në emër të Stefo Bua, i biri i Spiro, datëlindje 13.06.1953 dhe që ka burim fitimi pronësie Testamentin nr. 12 rep. Nr. 2 testamenti, datë 15.01.1986 realizuar para Zyrës së Ndihmës Juridike, për të cilin është lëshuar Dëshmia e Trashëgimisë me Vendimin nr. 683, datë 09.05.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
4. Ngarkohet Shërbimi përmbarimore shtetëror ose privat për ekzekutimin e këtij titulli.
5. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.
6. Kunder këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 5 diteve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi për palën paditëse prezent dhe nga dita e nesërme e marrjes dijeni për vendimin nga pala e paditur në mungesë.
7. U shpall në Vlorë, me datë 04.06.2015.

SEKRETARË
REZARTA LAZAJ



GJYQTARË
ELONA MIHALI

